



INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

IEKA

**Pasqyrat Financiare
për periudhën që mbyllet më datën
31 Dhjetor 2024**

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Asamblene e Anëtareve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Opinionit me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ("Instituti"), siç paraqiten në faqet 1 deri 17, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e burimeve të fondeve dhe perdorimeve dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në seksionin e *Bazës për Opinionin me Rezervë* të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pasqyrën e pozicionit financiar të Institutit me datën 31 Dhjetor 2024, dhe pasqyrën e burimeve të fondeve dhe perdorimeve dhe pasqyrën e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për OJF ("SKK për OJF").

Baza për opinionin me rezervë

1. Siç është shpalosur në shënimin 6 të pasqyrave financiare, llogaritë e arkëtueshme janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2024 në shumën prej 23,358,219 lekë. Gjatë auditimit tonë, kemi vërejtur se një pjesë e këtyre llogarive të arkëtueshme në shumën prej 13,573,808 lekë janë në vonësë dhe për to nuk është njohur asnjë zhvlerësim. Sipas opinionit tonë, kjo ka rezultuar në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme me 13,573,808 lekë në datën 31 Dhjetor 2024 dhe po të ishte njohur një zhvlerësim i përshtatshëm në këtë datë, llogaritë e arkëtueshme do të ishin zvogëluar, defiçiti për vitin do të ishte rritur dhe aktivet neto do të ishin zvogëluar për të njëjtën shumë. Opinionin nga një auditues tjetër për vitin që përfundoj më 31 Dhjetor 2023 ishte gjithashtu me rezervë për këtë çështje.

2. Siç është shpjeguar në shënimin 19 të pasqyrave financiare, Instituti është i përfshirë në disa procese gjyqësore, përfshirë çështje ligjore që lidhen me ish-drejtnes, ish-punonjës ose anëtar. Drejtimi ka njohur provigjione gjatë vitit 2024 vetëm për vendime gjyqësore të formës së prerë me një rezultat të pafavorshëm ku shuma e flukseve dalëse të parasë mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme. Megjithatë, për raste të tjera ekzistuese apo të mundshme, është konkluduar se nuk ka ndonjë zhvillim të qartë se si do jetë ecuria dhe nëse Instituti do të përballet me ndonjë detyrim të mundshëm apo jo në të ardhmen dhe për rrjedhojë, nuk është bërë asnjë provigjion për ndonjë detyrim shtesë të mundshëm në pasqyrat financiare. Ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi në lidhje me detyrimin e mundshëm apo ndikimin e tij në pasqyrat financiare. Për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse duhet të bëhet ndonjë rregullim në lidhje me provigjionet për rreziqe nga çështjet gjyqësore, si edhe për elementet përbërës të pasqyrës së burimeve dhe fondeve dhe flukseve të mjeteve monetare.

Baza për opinionin me rezervë (vazhdim)

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësiave të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Instituti në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standarteve Ndërkombëtare për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit (Kodi IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr.10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistëve të Miratuar”, të ndryshuar që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Çështje për tu theksuar

Pa e modifikuar më tej opinionin tonë, tërheqim vëmendjen për shënimin 19 të pasqyrave financiare, ku janë paraqitur burimet dhe përdorimet e fondeve financiare të Institutit për vitin 2024, të realizuara në krahasim me ato të buxhetuara.

Çështje tjetër

Pasqyrat Financiare të Institutit për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023, janë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka lëshuar një opinion me rezervë më 29 Prill 2024.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë Raportin e Ecurisë së Veprimtarisë për vitin 2024 për tu përgatitur në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr.25, datë 10.5.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë së Institutit për vitin 2024 pritet të na vihet në dispozicion pas datës të këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK për OJF, dhe për ato kontrole të brëndshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Institutit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Institutin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institutit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Institutit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Institutit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Instituti të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë, 2 Qershor 2025.

Fatos Beqja
Auditues Ligjor
FF-FB Sh.p.k
“A.Z. Çajupi” Street,
Pall Av. Vjeter, shk 5, ap 26.
Tirana, Albania
Mob +355 69 20 26226
fbeqja@ff-fb.com



INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Pasqyrat Financiare 31 Dhjetor 2024

Përmbajtja:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
PASQYRA E BURIMEVE TË FONDEVE	4
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	5
1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME.....	6
2. BAZA E PËRGATITJES	6
3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL.....	7
4. MJETET MONETARE	10
5. DEPOZITA ME AFAT	10
6. LLOGARI TË ARKËTUESHME	11
7. INVENTARËT	12
8. AKTIVE TË TJERA	12
9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE	12
10. LLOGARI TË PAGUESHME	13
11. DETYRIME TATIMORE.....	13
12. DETYRIME TË TJERA.....	13
13. NDRYSHIME NË AKTIVET NETO	14
14. KUOTA ANETARËSIMI.....	14
15. SHPENZIMET E PERSONELIT	14
16. HONORARE.....	15
17. BURIMET DHE PËRDORIMET PËR KUALIFIKIMIN.....	15
18. SHPENZIME ADMINISTRATIVE	16
19. DETYRIME TË KUSHTËZUARA	16
20. PALËT E LIDHURA	17
21. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	17

IEKA – INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 Dhjetor 2024

		31.12.2024	31.12.2023
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete Monetare	4	37,955,023	39,904,265
Depozita me Afat	5	44,769,492	44,184,032
Llogari të Arkëtueshme	6	23,358,219	23,003,844
Inventarët	7	350,199	331,399
Aktive të tjera	8	229,333	296,277
Totali i Aktiveve afatshkurtra (I)		106,662,267	107,719,818
Aktive Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	29,733,800	31,015,944
Aktive afatgjata jomateriale	9	402,547	327,258
Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		30,136,347	31,343,202
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		136,798,614	137,155,520
DETYRIMET DHE PASURIA NETO			
Detyrime			
Llogari të pagueshme	10	3,679,335	4,216,636
Detyrime tatimore	11	758,029	675,178
Detyrime të tjera	12	2,440,000	1,360,000
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra (I)		6,877,364	6,251,814
Totali i Detyrimeve		6,877,364	6,251,814
AKTIVET NETO	13	129,921,250	132,811,206

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga drejtuesit e Institutit dhe janë firmosur në datën 6 Mars 2025 nga:

Sektori i Financës

Drejtor Ekzekutiv



Silda Metani



Doranin Agalliu

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IEKA – INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR*(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)***PASQYRA E BURIMEVE TË FONDEVE****Për periudhën nga 01 Janar 2024 deri më 31 Dhjetor 2024**

		<u>2024</u>	<u>2023</u>
BURIMET E FONDEVE			
Burime nga veprimtaritë kryesore			
Kuota Anëtarësimi	14	31,122,311	28,836,259
Kualifikime	17	3,290,000	4,537,092
Botime		-	28,000
Të tjera		118,940	179,445
Totali i burimeve-të ardhurave		34,531,250	33,580,796
PËRDORIMET E FONDEVE			
Përdorimet për veprimtarinë kryesore			
Paga e punonjesve	15	(15,343,852)	(10,183,418)
Honorare Drejtimi	16	(5,593,000)	(6,036,525)
Kualifikime	17	(3,334,521)	(3,654,776)
Botime		(162,853)	(23,175)
Shpenzime Administrative	18	(13,403,120)	(11,876,944)
Totali i përdorimit të fondeve		(37,837,346)	(31,774,838)
(Deficiti)/teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore			
		(3,306,096)	1,805,958
Fitime/(humbje) nga kursi i këmbimi		1,181	(10,120)
Të ardhura nga interesat		414,959	396,513
Të ardhura financiare, neto		416,140	386,393
(Deficiti)/teprica i burimeve nga veprimtaria kryesore			
		(2,889,956)	2,192,351
Aktivët neto në fillim të vitit		132,811,206	130,709,673
Ulje e aktiveve neto nga gabime të tjera		-	(90,819)
Aktivët neto në fund të vitit	13	129,921,250	132,811,206

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IEKA – INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR*(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)***PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE****METODA INDIREKTE****Për periudhën nga 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2024**

	2024	2023
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Përdorime të fondeve per vitin	(2,889,956)	2,192,351
Rregullime për:		
Amortizimin	1,372,068	1,291,450
Efekti i rregullimit të gabimeve të periudhave të kaluara	-	(90,819)
Provigjione per rreziqe	1,173,360	1,280,000
Rënie në aktivet afatshkurtra	(306,231)	(1,970,074)
Rënie në detyrimet afatshkurtra	(547,810)	(948,186)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit	(1,198,569)	1,754,722
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese		
Ulje e depozitave me afat	(585,460)	(337,977)
Blerja e aktiveve afatgjata	(165,213)	(1,064,857)
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese	(750,674)	(1,402,834)
Rrjedha neto e parasë	(1,949,243)	351,888
Mjetet monetare në fillim të vitit	39,904,265	39,552,377
Mjetet monetare në fund të vitit	37,955,023	39,904,265

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

1. Informacione të përgjithshme

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (më poshtë “IEKA” ose “Instituti”), është një shoqatë profesionale që grupon Audituesit Ligjorë dhe Shoqëritë Audituese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. IEKA është krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 2 tetor 1995 dhe është regjistruar me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr. 3573, datë 16 tetor 1998. Instituti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (të ndryshuar), si dhe me Ligjin për “Organizatave jo-fitimprurëse” dhe me statutin e saj. Instituti është i regjistruar edhe në administratën tatimore dhe rregjistrin e pronarëve përfitues me NIPT K41605030L. Instituti është i regjistruar për përgjegjësitë tatimore e mëposhtëme:

- Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi
- Tatim i Mbajtur në Burim;
- Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore;

Veprimtaria kryesore e Institutit ka për qëllim të sigurojë që profesioni i Audituesit Ligjor (“AL”) vepron në përputhje me interesat e publikut si dhe të mbrojë etikën dhe pavarësinë e anëtarëve të tij. Veprimtaria e Institutit mbikëqyrret nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Selia e Institutit ndodhet në “Rruga e Elbasanit”, pallati Edil Al - IT, zyra 321, Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e përgatitjes

a. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF), në zbatim të udhëzuesit të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit për OJF-të, i ndryshuar 2018 dhe bazuar në politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme për qëllime të raportimit të IEKAs. Detajet e politikave të rëndësishme kontabël të Institutit janë përfshirë në Shënimin 3. Informacioni krahasues në këto pasqyra financiare është riparaqitur për të pasqyruar disa informacione shpjeguese shtesë dhe nuk ka rezultuar në rregullime të tjera.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

c. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase Lekë (ALL), e cila është monedha raportuese. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë. Për shkak të rrumbullakimeve, totalët në pasqyrat financiare dhe shënimet shoqëruese mund të mos përputhen me shumën e zerave në afërsinë më të afërt prej një lekë.

d. Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, IEKA parashikon se veprimtaria e saj do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

e. Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare kryesisht lidhet me aplikimin e parimit të vijimësisë.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme dhe te vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a. Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja në pasqyrën e pozicionit financiar konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës së raportimit. Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e monedhave të huaja që vijnë nga konvertimi njihen në pasqyrën e aktiviteteve. Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023, ka qënë respektivisht si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
1 USD	94.26	93.94
1 EUR	98.15	103.88

b. Njohja e burimeve dhe përdorimit të fondeve

Burimet janë hyrjet bruto nga kuotat e anetaresise dhe përfitimeve të marra nga shërbime të tjera gjatë periudhës dhe njihen mbi bazën e parimit të të drejtave të konstatuara. Kufizimet e vendosura nga anetarët e Institutit mund të përcaktojnë nëse të ardhurat nga burimet janë të kufizuara ose të pakufizuara.

(i) Burimet nga Kuota Fikse

Burimet nga kuota fikse vjetore përfaqësojnë kontributin e çdo anëtar, si për ata që e ushtrojnë profesionin ("AL Aktiv"), ashtu edhe për ata që nuk e ushtrojnë ("AL Pasiv"), sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve (shih shënimin 6.b dhe 6.c). Shuma e kuotës fikse njoftohet në fund të muajit janar dhe duhet të paguhet deri në fund të muajit shkurt të periudhës raportuese, në të cilën edhe njihet si e ardhur.

(ii) Burimet nga Kuotat Variabel

Burimet nga kuota vjetore variabël përfaqësojnë kontributin e çdo AL Aktiv që ushtron profesionin, qoftë si person fizik apo përmes një shoqërie auditimi. Kjo kuotë llogaritet si përqindje mbi të ardhurat bruto të realizuara, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve (shih shënimin 6.a). Shuma e kuotës variabël njoftohet në fund të muajit janar dhe duhet të paguhet deri në fund të muajit shkurt të vitit pasardhës të periudhës raportuese, në të cilën edhe njihet si e ardhur.

(iii) Burimet e Tjera

Burimet e Institutit përfshijnë gjithashtu të ardhurat nga veprimtari të tjera, si kualifikimi i vijueshëm, trajnimet, botimet, regjistrimi i anëtarëve të rinj, si edhe pajisja me vërtetime. Të ardhurat nga këto veprimtari njihen në momentin e realizimit të shërbimit.

(iv) Përdorimi i Fondeve

Përdorimet e fondeve njihen si shpenzime në pasqyrat financiare në periudhën kur janë kryer, pavarësisht nga momenti i pagesës. Keto përfshijnë edhe shpenzimet e realizuara gjatë vitit, por që nuk janë paguar deri në fund të periudhës raportuese.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

c. Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan kontributi i përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensione në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Institutit në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim i përfitimit të punonjësve në pasqyrën e të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

d. Të ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi në monedha të huaja paraqiten për shumën neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi nëse lëvizjet e monedhave të huaja janë në fitim ose humbje neto.

e. Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë gjëndjen në arkë dhe llogaritë rrjedhëse të cilat janë për një afat maturimi më pak se 3 muaj.

f. Depozitat me Afat

Depozitat me Afat përfshijnë gjëndjen në para në banka, të cilat janë për një afat maturimi me më shumë se 3 muaj.

g. Instrumentat Financiar

Instrumentet financiare jo derivative përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Instituti i njeh fillimisht këto instrumente financiare në datën që lind e drejta. Instituti regjistron një instrument financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivi financiar skadojnë, ose nëse Instituti transferon të drejtat për të arkëtuar flukset kontraktuale të parasë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Instituti ka një të drejtë ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përfitojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

h. Inventari

Inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit për llogaritë bazuar në metodën “hyrje e parë, dalje e parë”.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

i. Aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale

Aktivët Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale paraqiten paraqiten me kosto të pakësuar për amortizimin e akumuluar. Amortizimi llogaritet për të zvogëluar koston e aktiveve afatgjata pakësuar me vlerën e përlllogaritur të mbetur duke përdorur metodën e amortizimit mbi vlerën kontabël bruto për ndërtesën dhe vlerën kontabël neto për aktivet e tjera përgjatë jetës së tyre të dobishme. Normat respektive të amortizimit për periudhën raportuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve fikse	Normat e Amortizimit	
	2024	2023
Ndërtesa	2%	2%
Mjete transporti	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%
Software e të ngjashme	15%	15%

j. Provigjionet

Një provigjion njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Institutit i lind një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të parashikohet me siguri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjionet përcaktohen duke aktualizuar flukset e pritshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve.

k. Aktivet neto

Teprica midis burimeve dhe përdorimeve që krijohet në ushtrimin kontabël pasqyrohet në aktiveto neto të Institutit. Aktivët neto përfaqësojnë gjendjen neto ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve në datën e raportimit. Bazuar në ekzistencën ose jo të kufizimeve të vendosura nga anetarët, aktivët neto mund të jenë të kufizuara ose të pakufizuara.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare në banke dhe arkë janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024			31 Dhjetor 2023		
	Monedhe e huaj	LEKË	TOTALI	Monedhe e huaj	LEKË	TOTALI
Para ne arkë						
Para ne Arkë (Lekë)	-	1,217	1,217	-	83,522	83,522
Para ne Arkë (Euro)	32,745	-	32,745	34,656	-	34,656
Totali ne arkë	32,745	1,217	33,962	34,656	83,522	118,178
Para ne bankë						
Intesa SanPaolo (Lekë)	-	17,481,297	17,481,297	-	17,568,977	17,568,977
BKT (Lekë)	-	61,825	61,825	-	17,734,117	17,734,117
BKT (Euro)	11,349	-	11,349	195,762	-	195,762
BKT-Provimet (Lekë)	-	972,576	972,576	-	594,021	594,021
Raiffeisen Bank (Usd)	(5,920)	-	(5,920)	245	-	245
Raiffeisen Bank (Lek)	-	19,399,934	19,399,934	-	3,692,964	3,692,964
Totali ne Bankë	5,430	37,915,632	37,921,062	196,007	39,590,079	39,786,086
Totali ne Arkë dhe Bankë	38,174	37,916,849	37,955,023	230,664	39,673,601	39,904,265

Para ne bankë përfaqëson llogari rrjedhëse të cilat nuk përfitojnë interes dhe janë disponibël për aktivitetin dhe veprimtarinë ditore të Institutit përveç kufizimeve në llogarinë Raiffeisen Bank (Lek) për vlerën 4,589 lekë vendosur nga Bashkia Tiranë.

5. Depozita me afat

Mjetet monetare të investuara në depozita, sipas afatit të maturimit 12 muaj, paraqiten si më poshtë:

		31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Depozita me afat 12 muaj	Data Maturimit		
BKT	15 Prill 2025	16,568,490	16,323,868
Intesa SanPaolo	25 Mars 2025	7,500,000	7,500,000
Credins Bank	15 Qershor 2025	20,701,002	20,360,165
Totali		44,769,492	44,184,032

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 të ardhurat nga interesi te njohura janë 414,959 lekë (2023: 396,513 lekë). Norma efektive e interesit vjetor gjatë vitit 2024 është 1.75% për BKT, 1.9% për Credins Bank dhe 0.9% për Intesa San Paolo. Depozitat bankare janë në monedhën lekë, me afat maturimi 12 mujore dhe interesi maturohet në fund të afatit.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

6. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë të detajuara si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Kuota Variabël AL Aktiv (referoju "a" me poshtë)	13,347,260	12,739,309
Kuota Fikse AL Aktiv (referoju "b" me poshtë)	4,092,816	4,327,891
Kuota Fikse AL Pasiv (referoju "c" me poshtë)	4,736,177	4,504,678
Kualifikime (referoju "d" me poshtë)	1,116,966	1,206,966
Rregjistrime (referoju "e" me poshtë)	65,000	225,000
	23,358,219	23,003,844

- Kuota Variabel aktuale për llogaritët mbi nivelin e të ardhurave totale vjetore dhe është 0,5% për nivelin nga 0-8 milion lekë dhe 0,3% për nivelin mbi 8 milion lekë si dhe është e përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 126 të datës 29.06.2020.
- Kuota Fikse vjetore aktuale e anëtarëve AL aktiv është 60,000 lekë si dhe është e përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 146 të datës 17.12.2020.
- Kuota Fikse vjetore aktuale e anëtarëve AL pasiv është 8,000 lekë si dhe është e përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 107 të datës 28.06.2014.
- Të drejtat nga kualifikimet nuk janë arkëtuar ndër vite nga stazhierët e praktikës profesionale.
- Rregjistrime për tu arkëtuar përfaqësojnë antarët të cilët janë regjistruar, reregjistruar apo ç' regjistruar si person fizik apo shoqëri.

Analiza e vjetërsisë për llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2024 është e detajuar si më poshtë:

Përshkrimi	Pa Vonesë	Me vonesë deri 12 Muaj	Me vonesë mbi 12 Muaj	Totali
Kuota Variabël	9,906,089	3,441,171	-	13,347,260
Kuota Fikse Aktiv	(64,366)	402,040	3,755,142	4,092,816
Kuota Fikse Pasiv	(27,312)	154,934	4,608,555	4,736,177
Kualifikime	-	1,026,966	90,000	1,116,966
Rregjistrime	(30,000)	35,000	60,000	65,000
	9,784,411	5,060,111	8,513,697	23,358,219

Drejtimi vazhdon të jenë në një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Institutit për të rakorduar vjetërsinë dhe arkëtimin e kuotave dhe të drejtave të tjera sipas përcaktimeve në statutin e Institutit.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

7. Inventarët

Inventarët e botimeve dhe librave janë të përbërë si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
SNA	85,920	85,920
Udhërrëfyesi	81,404	81,404
Guida	63,450	63,450
Revista	52,334	52,334
Libra	18,800	-
Kodi Etikës	908	908
Të tjera	47,383	47,383
Totali	350,199	331,399

Inventarët e librave janë rritur pasi janë blerë disa libra gjatë vitit me kosto 18,800 lekë.

8. Aktive të tjera

Aktive të tjera përfaqësojnë të drejtat e Institutit si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2024	Dhjetor 2023
Parapagime Personeli	117,333	-
Detyrime nga Keshilltar Ligjor	112,000	112,000
Interesa te perlllogaritura	-	184,277
	229,333	296,277

9. Aktivitet afatgjatë materiale dhe jomateriale

Aktive afatgjatë materiale dhe jomateriale në datë 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen nga sa vijon:

	Ndërtesa	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Software e të ngjashme	Total
Kosto						
Më 31 Dhjetor 2023	47,455,444	3,273,550	5,587,162	6,173,333	331,400	62,820,889
Shtesa	-	-	-	36,400	128,814	165,214
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	47,455,444	3,273,550	5,587,162	6,209,733	460,214	62,986,103
Amortizimi i akumuluar						
Më 31 Dhjetor 2023	18,035,461	2,848,828	5,253,947	5,335,310	4,142	31,477,688
Amortizimi vjetor	949,109	84,944	66,643	217,847	53,524	1,372,068
Më 31 Dhjetor 2024	18,984,570	2,933,772	5,320,590	5,553,157	57,666	32,849,756
Vlera Neto Kontabël						
Më 31 Dhjetor 2023	29,419,983	424,722	333,215	838,023	327,258	31,343,202
Më 31 Dhjetor 2024	28,470,874	339,778	266,572	656,576	402,547	30,136,347

Ndërtesa përfaqëson selinë dhe zyrat e Institutit, me një sipërfaqe prej 245.3 m². Vlera e drejtë e ndërtesës, bazuar në vlerën e taksueshme në fuqi në datën e raportimit (i.e Lek 240,600/m²), gjykohet të jetë rreth 59 milion lekë. Aktivitet afatgjatë të Institutit, përfshirë ndërtesën dhe mjetin e transportit, nuk janë të lëna si peng ose kolateral dhe nuk mbartin asnjë barrë sigurie.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

10. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme në datën 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Detyrim për tarifen për BMP	3,493,875	2,519,355
Innova Tech	72,000	20,000
Futura Fusion Technology	36,000	60,000
Albania Diving Center	22,077	23,577
FSHU sh.a	17,087	13,861
ONE Albania	6,000	11,900
UKT sh.a	3,216	2,076
Xheko sh.p.k	-	601,000
Infosoft Software Developer	-	331,400
Honorare dhe te ngjashme	-	283,667
Auditues Ligjor	-	280,000
Bota Shqipëtare	-	69,800
Të tjerë	29,080	-
Totali	3,679,335	4,216,636

11. Detyrime tatimore

Llogaritë e pagueshme në datën 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen nga:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Tatim mbi te Ardhurat Personale	265,637	191,100
Tatim në Burim	212,377	227,243
Sigurime Shoqërore & Shendetesore	280,015	256,835
	758,029	675,178

Detyrimet tatimore me 31 Dhjetor 2024 përbëhet nga detyrimet për muajin Dhjetor 2024 të cilat janë shlyer në Janar 2025.

12. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera në datën 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhen nga:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Provizione për rreziqe nga çështjet gjyqësore	2,440,000	1,280,000
Kuota Anëtarësie të marrë në avancë	-	60,000
Tarifa Regjistrimi të marrë në avancë	-	20,000
	2,440,000	1,360,000

Provizione për rreziqe nga çështjet gjyqësore kanë lidhje me çështje ku Instituti është i paditur për ndërprerje të njëanshme të marrëdhënies së punësimit me ish-drejtnes dhe ish-punonjës (shih shënimin 19).

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR**Shënime për pasqyrat financiare****31 Dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)***13. Ndryshime në aktivet neto**

Aktivet neto te Institutit paraqitet si më poshtë:

	Të pakufizuara	TOTAL
Teprica në 31 Dhjetor 2023	132,811,206	132,811,206
Ulje nga aktiviteti ushtrimor	(2,889,856)	(2,889,856)
Balanca mbyllëse në 31 Dhjetor 2024	129,921,250	129,921,250

14. Kuota Anëtarësimi

Kuota Anëtarësimi për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 përbëhen nga:

	2024	2023
Kuota Variabel AL Aktiv (referoju "6.a" me lart)	11,948,478	10,970,268
Kuota Fikse AL Aktiv (referoju "6.b" me lart)	14,907,500	14,445,000
Kuota Fikse AL Pasiv (referoju "6.c" me lart)	1,449,333	1,399,976
Rregjistrime (referoju "6.e" me lart)	2,817,000	2,021,015
	31,122,311	28,836,259

15. Shpenzimet e Personelit

Shpenzimet e Personelit përfaqëson pagat e personelit, kontributet për sigurime shoqërore dhe pagesa te tjera për punonjësit e IEKA për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 dhe përbëhen nga

	2024	2023
Pagat e personelit	12,979,897	8,806,247
Kontribute për sigurime shoqërore	2,034,455	1,222,319
Të tjera	329,500	154,852
	15,343,852	10,183,418

Të tjera përfshijn kontribute shtesë për personelin, si honorarë për sekretarinë teknike të KPAP-së për orë jashtë orarit, si dhe pagesat për leje vjetore.

Gjatë vitit 2024, IEKA ka pasur gjithsej 10 punonjës me kohë të plotë. Nga këta, 9 punonjës kanë qenë të angazhuar gjatë gjithë vitit, ndërsa 1 punonjëse ka qenë e punësuar përkohësisht gjatë periudhës korrik-tetor 2024.

Gjatë vitit 2023, numri i punonjësve me kohë të plotë ka qenë 8. Nga këta, 6 punonjës kanë qenë të angazhuar gjatë gjithë vitit, ndërsa 2 punonjës janë punësuar duke filluar nga fillimi i muajit Nëntor 2023.

Pozicionet në strukturën ekzekutive, si dhe pagat për personelin për vitet 2024 dhe 2023, janë përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 39, datë 04.07.2022, dhe ndryshuar me vendim nr. 50, datë 22.12.2023.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2024

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

16. Honorare

Honoraret përfaqësojnë pagesat të anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Komiteteve të IEKAs dhe për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 përbëhen nga sa më poshtë:

	2024	2023
Këshilli i Drejtimit (referoju "a" më poshtë)	3,752,000	4,108,000
Komiteti i Kontrollit të Brendshëm (referoju "b" më poshtë)	300,000	300,000
Komiteti Edukimit Kualifikimit të Vijueshëm (referoju "c" më poshtë)	701,000	726,800
Komiteti i Regjistrimit (referoju "c" më poshtë)	345,000	456,725
Komiteti i Investigimit e Disiplinës (referoju "c" më poshtë)	330,000	236,000
Komiteti i Kontrollit të Cilësisë (referoju "c" më poshtë)	165,000	136,000
Komiteti i Standarteve Profesionale e Etikës (referoju "c" më poshtë)	-	68,000
Komiteti Programeve Alternative (referoju "c" më poshtë)	-	5,000
	5,593,000	6,036,525

(a) Honoraret e Këshillit të Drejtimit përbëhen nga (i) pagesa fikse mujore prej 165,000 lekë për Kryetarin, 25,000 lekë për Zv.Kryetarin dhe 12,000 lekë për secilin anëtar si dhe (ii) pagesa për pjesëmarrjen në mbledhjet periodike në shumën prej 18,000 lekë për Kryetarin dhe 15,000 lekë për secilin anëtar.

(b) Honorarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm përbëhen nga një pagesë fikse vjetore në shumën prej 100,000 lekë për secilin anëtar.

(c) Honorarët e Komiteteve të tjera përbëhen nga pagesa për pjesëmarrjen në mbledhjet periodike në shumën prej 15,000 lekë për Kryetarin dhe 12,000 lekë për secilin anëtar.

Honoraret për pagesat fikse gjatë viteve 2024 dhe 2023 për Këshillin e Drejtimit dhe Komitetit të Kontrollit të Brendshëm janë brënda tavanëve buxhetore të aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Honoraret e paguara gjatë viteve 2024 dhe 2023 për Këshillin e Drejtimit në pjesëmarrjen në mbledhjet periodike janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Drejtimit nr. 15, datë 28.12.2012. Honoraret e paguara gjatë viteve 2024 dhe 2023 për Komiteteve të tjera janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Drejtimit nr. 63, datë 17.12.2021.

17. Burimet dhe Përdorimet për Kualifikimin

Burimet dhe Përdorimet për Kualifikimin për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 përbëhen nga si më poshtë:

Burimet	2024	2023
Auditues Ligjor	914,000	1,519,082
Kandidat AL	2,376,000	3,018,010
Totali i burimeve	3,290,000	4,537,092
Perdorimet		
Auditues Ligjor	1,303,571	1,369,821
Kandidat AL	2,030,950	2,284,955
Totali i përdorimeve	3,334,521	3,654,776

Të ardhurat nga audituesit ligjorë përfaqësojnë tarifat për kualifikimin e detyrueshëm, të aplikuara për anëtarët që nuk kanë marrë pjesë në sesionet vjetore të kualifikimit profesional vijues. Të ardhurat nga kandidatët për titullin "Auditues Ligjor" përfaqësojnë tarifat e kualifikimit përgjatë periudhës trevjeçare të ndjekjes së praktikës profesionale, me një tarifë vjetore prej 30,000 lekësh

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR**Shënime për pasqyrat financiare****31 Dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)***18. Shpenzime administrative**

Shpenzimet administrative të Institutit për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 përbëhen nga si më poshtë:

	2024	2023
Tarifa për BMP (referoju "a" më poshtë)	5,492,991	2,114,532
Amortizim dhe zhvleresim (shih shenimin 9)	1,372,068	1,291,450
Kuota Anëtarësimi (referoju "b" më poshtë)	1,206,618	1,485,230
Provigjionim ligjor dhe te lidhura (shih shenimin 12 dhe 19)	1,173,360	1,950,370
Mbledhje dhe takime Asambleje	1,120,421	287,727
Udhëtime dhe dieta	442,709	606,834
Mirembajtje web dhe rregjistri publik	432,000	-
Shërbime komunikimi dhe interneti	361,098	575,301
Shpenzime te tjera	332,096	255,890
Kancelari	281,892	-
Shërbime nga te trete	272,424	272,377
Energji dhe uje	192,971	170,019
Reklama dhe njoftime	190,308	-
Taksa dhe Tarifa Vendore	148,227	133,092
Mirembajtje dhe karburant	121,502	45,600
Komisione bankare	105,699	275,183
Shërbime auditimi	75,200	280,850
Të paparashikuara	44,302	421,469
Pritje & perçjellje	19,080	1,337,575
Taksa, sigurime dhe parkime	18,155	67,249
AAM të Crrregjistruara	-	49,944
Shpenzime Material Konsumi	-	249,716
Të tjera	-	6,535
	13,403,120	11,876,944

(a) Tarifa për BMP përfaqëson kontributin e pjesshëm për vitin 2023 dhe atë të plotë për vitin 2024.

(b) Kuotat e anëtarësisë përfaqësojnë pagesat periodike e kryera nga IEKA ndaj organizmave profesionale ndërkombëtare, në të cilët është anëtarësuar.

19. Detyrime të Kushtezuara

IEKA është e përfshirë në disa çështje gjyqësore në proces si e paditur dhe si paditëse objekti i të cilave ka të bëjë me aktivitetin operacional të organizatës.

Si palë e paditur Organizata është e paditur në procese gjyqësore të ngritura nga anëtarë të Organizatës nga të cilat dy anëtar janë tërhequr nga padia dhe një e tretë është pushuar nga gjykata e shkallës së parë dhe drejtuesit nuk kanë dijeni nëse pala paditëse ka bërë ankimin në gjykatën e apelit apo jo për pushimin e çështjes.

Padi të tjera janë në proces gjykimi ku palët paditëse kërkojnë dëmshpërblim për ndërprerje pa shkak të marrëdhënies së punësimit. Për dy prej tyre ka vendime gjyqësore të cilat kanë vendosur pranimin të pjesshëm të padisë duke i kërkuar Institutit të dëmshpërblejë ne shumat 2,440,000 lekë të cilat janë provigjionuar (shih shenimin 12).

Për çështje të tjera gjyqësore në proces nuk ka ndonjë zhvillim të qartë se si do jetë ecuria dhe nëse Instituti do të përballet me ndonjë detyrim të mundshëm apo jo në të ardhmen. Për këtë arsye drejtuesit mendojnë se nuk ka nevojë për të krijuar ndonjë provizion shtesë. Proceset e ngritura nuk kanë ndikuar dhe nuk do të ndikojnë në vijimësinë e aktivitetit.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR**Shënime për pasqyrat financiare****31 Dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)***19. Detyrime të Kushtezuara (vazhdim)****Buxheti**

Buxheti i vitit 2024, sipas përcaktimit në nenin 8.1 të Statutit është miratuar nga Asambleja së Përgjithshme të Anëtarëve me vendim nr. 157 të datës 07.12.2023 dhe ndryshuar me vendim nr. 166 të datës 18.12.2024. Burimet dhe përdorimet e fondeve financiare të Institutit për vitin 2024 janë realizuar si më poshtë:

	Per vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2024		
	Buxheti (B)	Realizimi (R)	R-B
BURIMET E FONDEVE			
Burime nga veprimtaritë kryesore			
Kuota Anëtarësimi	28,925,000	31,122,311	2,197,311
Burime nga Kualifikime	3,100,000	3,290,000	190,000
Të tjera	-	118,940	118,940
Totali i burimeve-të ardhurave	32,025,000	34,531,250	2,506,250
PËRDORIMET E FONDEVE			
Përdorimet për veprimtarinë kryesore			
Paga e Punonjesve	14,880,000	15,343,852	463,852
Honorare Drejtimi	5,850,000	5,593,000	(257,000)
Shpenzime per Kualifikime	3,900,000	3,334,521	(565,479)
Shpenzime per Botime	200,000	162,853	(37,147)
Shpenzime Administrative	8,192,000	13,403,120	5,211,120
Totali i përdorimit të fondeve	33,022,000	37,837,346	4,815,346
Deficiti i burimeve nga veprimtaria kryesore			
	(997,000)	(3,306,096)	(2,309,096)
Fitime nga kursi i këmbimi	-	1,181	1,181
Të ardhura nga interesat	250,000	414,959	164,959
Të ardhura financiare, neto	250,000	416,140	166,140
Deficiti i burimeve nga veprimtaria kryesore			
	(747,000)	(2,889,956)	(2,142,956)

20. Palët e Lidhura

Palët konsiderohen të jenë të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar ose ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër për marrjen e vendimeve financiare ose operacionale. Këshilli i Drejtimit, Komiteti i Kontrollit të Brendshëm dhe Drejtori Ekzekutiv janë të ngarkuar sipas statutit të Institutit për të kryer rolin dhe përgjegjësitë e personelit kyç të drejtimit dhe për rrjedhojë, autoriteti dhe përgjegjësia për planifikim, drejtimin dhe kontrollin e aktiviteteve të Institutit i është caktuar këtyre organeve ekzekutive.

Gjate vitit 2024, honoraret (shih shënimin 16.a) për Këshillin Drejtues janë 3,752,000 lekë (2023: 4,108,000 lekë) ndërsa paga vjetore e Drejtorit Ekzekutiv është 2,476,669 leke (2023: 2,390,072 leke). Honoraret (shih shënimin 16.b) për Komitetin e Kontrollit të Brëndshëm janë 300,000 lekë për seicilin vit.

Tarifa vjetore e auditimit ligjor për vitet 2024 dhe 2025 është 280,000 lekë.

21. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.